



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KF.nr.27/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi në konfliktin administrativ të paditësit “N...” L.L.C me seli në Gjilan, Rr. ... pn, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti detyrime doganore shtesë, vlerë kontesti 8,849.88 euro, në seancën e shqyrtimin kryesor-publik të datës 20.09.2022, të mbajtur në mungesë të palës paditëse dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur M.K, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “N...” L.L.C me seli në Gjilan, Rr. Lidhja e Prizrenit pn, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr. 07.3/1071-2015 i datës 30.05.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

### A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 12.06.2019, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 07.3/1071-2015 i datës 30.05.2019, për shkak të shkeljeve esenciale të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale pasi që nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore (neni 16, paragrafi 1.1 i LKA-së), për shkak të mos vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, për shkak se pala e paditur e ka nxjerr përsëri

aktiv e vet të mëparshëm më parë të anuluar dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Tutje paditësi në padi deklaron se aktvendimi kontestues nuk përmban elementet esenciale të një akti juridik administrativ, pasi që është jo i plotë, i pakuptueshëm dhe përsëri i paarsyetuar. Sipas këtij vendimi nuk është e qartë se si ka ardhur deri te konstatimi se paditësi duhet paguar taksa doganore shtesë dhe nuk ka sqarime se përse e paditura nuk i ka besuar normativit të cilin vet e ka aprovuar. Gjithashtu, nuk jepet baza ligjore për pretendimet e paraqitura në aktvendimin e kontestuar. Vetëm janë paraqitur thëniet dhe vërejtjet e gjykatës të evidentuara në aktgjykimin e saj, por nuk ka përgjigje konkrete dhe as tendenca minimale për rregullimin e situatës së evidentuar. Konform nentit 84 të LPA-së, akti administrativ duhet të përmbaj një përmbledhje të gjendjes faktike dhe një deklaram të bazës ligjore, gjë e cila nuk ka ndodhur në rastin konkret. Gjithashtu paragrafi 3 i të njëjtit nen parasheh që “arsyetimi më të dhëna të paqarta, kontradiktore ose të pasakta, është i barasvlerëshëm me mungesën e arsytimit. E paditura ka shpërfillur në tërësi kërkesat dhe vërejtjet e gjykatës të dhëna përmes aktgjykimit të saj të plotfuqishëm. Duke qenë së pala e paditur ka dëshmuar se nuk është e gatshme as që të bëjë përpjekje minimale për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike, kërkojmë nga Gjykata që konfrom dispozitave ligjore pozitive të LKA-së, të konstatoj gjendjen faktike dhe të nxjerr aktin administrativ në vend të doganës. Në fund paditësi kërkon nga gjykata që të hap shqyrtim gjyqësor, të administroj provat dhe të bjer aktgjykim me të cilin aprovohet padia e paditësit si e bazuar, të anulohet aktvendimi i të paditurës nr.07.3/1071-2015 i datës 30.05.2019, si i pabazuar dhe kundërligjor dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia rimburoj taksën e paguar në lartësi prej 8,849.98€, në afat prej 15 ditësh pas dhënies së këtij vendimi. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë e datës 08.09.2020 e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme, andaj i propozon gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pa-bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Në seancën

e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi e të paditurës deklaroi se paditura e kontestoi në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi, andaj e paditura i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marrë aktgjykim me të cilin e refuzoi në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe lenë në fuqi aktvendimin e kontestuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se pala paditëse edhe pse është ftuar për seancë në mënyrë të rregullt, e njëjta nuk ka qenë prezentë dhe nuk e ka arsyetuar mungesën (prove: fletë kthesa e datës 02.09.2022 e pranuar nga paditësi).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 20.09.2022 ka administruar provat dhe atë: Aktgjykimi A.nr.127/16 i datës 10.04.2019, Autorizimi për Përpunim të Brendshëm Nr. ..., i datës 02.09.2014, Shënimet Shpjeguese për Produktet Kompenzuese të datës 24.10.2014, 05.02.2014, Përgjigja në Padi e datës 08.09.2020, Aktvendimi 07.3/1071-2015, i datës 30.05.2019, Aktvendimi 07.3/1071 i datës 05.11.2015, DUD-at nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ..., Listë-Distribuími e Doganës së Kosovës e datës 03.07.2014, së bashku me Tabelat e DUD-ave përkatës, Raporti për Doganë nga subjekti - këtu paditësi për DUD-at kontestues, Aktvendimi 03.2/1183 i datës 14.10.2015, Shënimi i Brendshëm i Doganës së Kosovës i quajtur Konstatim i Gjendjes i datës 12.10.2015, Kërkesa për Rishqyrtim e ushtruar në Doganën e Kosovës Nr. ..., Kërkesa për Asgjësim të Mbeturave të ushtruar në Doganën e Kosovës e datës 05.09.2013, Parashtrësa Sqarim për Doganën e Kosovës e datës 06.08.2014, së bashku me Tabelat përkatëse.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se Sektori për Mbikëqyrjen e Regjimeve Pezulluese i Doganës së Kosovës me aktvendimin nr.03.2/1183 të datës 14.10.2015, e ka obliguar paditësin që të paguaj taksën Doganore dhe TVSH-në në vlerë prej 8,849.98€, për lëndën e parë të harxhuar më tepër në sasi prej 19,797.64 kg në vlerë financiare 33,695.20€. Kundër këtij vendimi paditësi ka ushtruar në Doganën e Kosovës e cila me aktvendimin nr.07.3/1071 të datës 05.11.2015, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit. Jokontestues mbetet edhe fakti se paditësi ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër aktvendimit të Doganës së Kosovës nr.07.3/1071 të datës 05.11.2015, për të cilën padi gjykata ka marr aktgjykimin A.nr.127/16 të datës 10.04.2018 për aprovimin e padisë si të bazuar dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura, e ç’rast e paditura Dogana e Kosovës me datë 30.05.2019. Jo kontestuese mbetin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 23.10.2018, ka sjell Aktvendimin nr. ..., si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës, 12.06.2019 përsëri, ka iniciuar konfliktin administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës duke vepruar sipas ankesës së paditësit, e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë “N...” LLC me seli në Gjiilan, këtu paditësit, për rishqyrtimin e vendimit nr.03.2/1183 i datës 14.10.2015 të lëshuar nga Sektori për Mbikëqyrjen e Regjimeve Pezulluese. E paditura ne vendimin kontestues sqaron se Sektori për Mbikëqyrjen e Regjimeve Pezulluese vendimin e vet e ka mbështetur në analizat e bëra të detajuara në Shënimin e Brendshëm nr. ... datë 14.10.2015, ku është konstatuar se paditësi gjatë aktivitetit të tij në Përpunim të Brendshëm me Sistem Pezullimi, për sasinë e mallit të rikuperuar, respektivisht produktin kompenzues me përshkrimin tepihë të bëra me makinë nga polipropileni në sasi prej 7,226.93kg (2,890.77m<sup>2</sup>), sipas normativit është dashtë të shpenzoj lëndë të parë të kreut tarifor 5402 në sasi prej 4,382.41kg dhe lëndë të

parë të kreut tarifar 5303 në sasi prej 1,896.35kg, mirëpo, sipas të dhënave të sistemit të aplikuar për qasje në Deklaratat Unike Doganore për realizimin e 7,226.93kg produkt parësor, është harxhuar lëndë e parë në sasi prej 26,076.40kg, respektivisht ndryshimi në mes të sasisë së harxhuar dhe sasisë që është dashur të harxhohet, nuk është trajtuar në njërin nga procedurat e lejuara doganore, andaj nga kjo rezulton se harxhimi i lëndës së parë në raport me produktin kompenzues nuk përkon me normativin dhe sipas analizave të bëra për lëndën e parë për përpunim, është konstatuar se sipas të dhënave të aplikueshme është harxhuar lëndë e parë më shumë se sa është dashur të harxhohet në raport me normativin në sasi prej 19,797.64kg në vlerë financiare prej 33,695.20€.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadsisë, në vështrim të nenit 44, paragraf 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas paragraf 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i marrë për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata vlerëson si të pa-bazuar pretendimin e paditësit për shkelje esenciale të dispozitave të KDA-së, për arsye se e paditura vendimin e vet e ka mbështetur në sqarimet e dhëna në vendimin ... të datës 14.10.2015 të Sektorit të mbikëqyrjes së Regjimeve Pezulluese, në të cilin në mënyrë të detajuar është përshkruar gjendja faktike duke u mbështetur në shënimin e brendshëm nr. ... të datës 14.10.2015, ku të dhënat e marra nga ky shënim janë obligative për tu zbatuar nga Dogana e Kosovës. Ndërsa paditësi në padinë e tij nuk e ka dhënë asnjë sqarim se përse konstaton se kanë ndodhur shkelja esenciale të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Tutje Gjykata vlerëson se nuk është i bazuar as pretendimi tjetër i paditësit, lidhur me shkeljet e procedurës administrative nga e paditura, për arsye se në vendimin kontestues e paditura ka sqaruar në përpikëri rrjedhën e procedurës deri në vendimin përfundimtar, ndërsa paditësi në padinë e tij nuk ka paraqitur ndonjë pretendim në të cilin do të sqaronte

se cilat janë ato shkelje esenciale te dispozitave procedurale dhe ku e mbështet konstatimin e tij se nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore.

Në vijim Gjykata, pretendimin e paditësit se aktvendimi i kontestuar nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, prandaj si i tillë kërkon që të anulohet, përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7, Parag 1, dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave te provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore te përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38, par 2, të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtoj faktet, në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte, të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat lidhur me normativon shpenzues ndryshe nga normativi i përcaktuar me autorizimin përkatës nga e paditura.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marr konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 parag, 1, dhe nenit 46, parag. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.27/22 datë 20.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar GASHI

---

Gj y q t a r i,

Fisnik NULI

---

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.